Në bazë të nenit 166 të Ligjit për arsimin e lartë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 82/2018), Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës si dhe në mbështetje të nenit 144 të Statutit të Universitetit të Tetovës, Këshilli Mësimor-Shkencor i Fakultetit të Shkencave Matematike - Natyrore në lidhje me konkursin për zgjedhje-rizgjedhje të shpallur me datën 18.05.2020 në Gazetën “Koha”, “Nova Makedonija” dhe Ueb faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës, në mbledhjen e mbajtur më 1.06.2020 sjell Vendim (nr. 15-604/1) për formimin e komisionit recensues. Formohet komisioni për zgjedhje-rizgjedhje të një mësimdhënësi për lëndët: **Hapësirat metrike, Masa dhe integrali dhe Analiza komplekse** (në programin studimor Matematikë) në përbërjen si më poshtë:

1. Dr. Risto Malçeski, profesor ordinar, Fakulteti Arkitektonik, Universiteti FON, Shkup,
2. Dr. Biljana Krsteska, profesor ordinar, Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore, Universiteti “Shën Kirili dhe Metodi”, Shkup,
3. Dr. Alit Ibrahim, profesor inordinar, Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore, Universiteti i Tetovës, Tetovë.

Komisioni në përbërje të plotë, si më sipër, pasi e kontrollon materialin e konkursit, titullit të lartë përmendur i paraqet këtë

RECENSION

Nga konkursi i publikuar më 18.05.2020 në gazetën “Koha” dhe “Nova Makedonija” mund të shihet se në të është shpallur për zgjedhje vendi i punës i një mësimdhënësi universitar në Programin studimor të Matematikës në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore për lëndët **Hapësirat metrike, Masa dhe integrali dhe Analiza komplekse** (në programin studimor Matematikë).

Pas kontrollimit të materialit të konkursit, nga dokumentacioni, komisioni konstatoi se në konkurs është paraqitur vetëm një kandidat, edhe atë Krutan Rasimi, docent në departamentin e Matematikës në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore të Universitetit të Tetovës.

I. TË DHËNA BIOGRAFIKE DHE ZHVILLIMI PROFESIONAL

Krutan Rasimi ka lindur në Reçicë të Vogël, Tetovë, më 21.08.1971 ku edhe ka mbaruar shkollimin fillor. Shkollimin e mesëm, Gjimnazin “Kiril Pejçinoviç”– Tetovë, drejtimi matematikë-informatikë e ka kryer në vitin 1990. Pastaj, në vitin 1992 ka vijuar studimet universitare në Departamentin e Matematikës të Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore në Zagreb, Republika e Kroacisë. Më datë 10.02.1998 mbrojti punimin e diplomës të titulluar “*Principet e variacionit dhe principi i Fejmanit në mekanikën klasike dhe kuantike*”, me çka fitoi titullin **Profesor i matematikës dhe fizikës** (shkalla VII/1).

Më pas, në vitin akademik 2007/08, ka regjistruar studimet e magjistraturës në departamentin e Matematikës në FSHMN – Prishtinë, Republika e Kosovës, ku, pas dhënies me sukses të të gjitha provimeve të parapara sipas plan-programit të studimeve, ka mbrojtur me sukses më 12.05.2010 punimin e magjistraturës me titull “*Operatorët hipernormalë, paranormalë dhe kuazidiagonalë në hapësirat e Hilbertit*” me çka ka marrë titullin **Magjistër i shkencave të matematikës**.

Në vitin akademik 2010/11 është regjistruar në studimet e doktoratës në Fakultetin e Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizikë të Universitetit Politeknik në Tiranë, ku, pas miratimit të temës së disertacionit “*Kontribut mbi disa klasa operatorësh në hapësirat e Hilbertit*”, nga Këshilli i Rektoratit të UPT-së, të njëjtën e ka mbrojtur me sukses më 28.05.2015 dhe ka fituar titullin **Doktor i shkencave të matematikës**.

Nga viti 1998 e deri më vitin 2004 ka punuar si profesor i matematikës në shkollën e mesme “Mosha Pijade” Tetovë, kurse nga viti 1999 edhe si asistent në Universitetin e Tetovës. Në vitin 2004 zgjidhet *asistent i ri* e më pas, në vitin 2008, rizgjidhet në të njëjtën thirrje në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore të Universitetit të Tetovës në Programin studimor *Matematikë*, kurse në vitin 2013 është zgjedhur asistent po në programin e njëjtë studimor. Më datë 29.10.2015 është zgjedhur në thirrjen docent në programin studimor Matematikë të Fakultetit të Shkencave Matematike – Natyrore të Universitetit të Tetovës.

Kandidati për qëllime profesionale në mënyrë aktive shërbehet me gjuhët e huaja anglisht, kroatisht.

II. VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE

Gjatë periudhës që ka punuar si docent, kandidati Krutan Rasimi ka mbajtur, përveç ligjëratave nga kurset për të cilët ishte zgjedhur Masa dhe integrali dhe Analiza komplekse, ashtu edhe ligjërata nga kurset Analizë matematike I dhe II, Algjebër lineare dhe Metoda matematike në fizikë I në programin studimor Fizikë). Ai ka realizuar edhe ligjëratat nga kurset Hapësirat metrike dhe Hyrje në topologji në programin studimor Matematikë. Në ciklin e dytë të studimeve ka qenë i angazhuar për realizimin e kursit Analizë funksionale në drejtimin e Matematikës.

Në përputhje me Rregulloren për kriteret dhe procedurën e zgjedhjes në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe bashkëpunëtor në Universitetin e Tetovës (Buletini i universitetit), kandidati Krutan Rasimi ka realizuar gjithsej **98.88 pikë** nga veprimtaria mësimore-arsimore.

III. VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE

Krahas angazhimit në procesin mësimor, kandidati është marrë në vazhdimësi me hulumtim në fushën e matematikës, përkatësisht analizës matematike dhe analizës funksionale-teori të operatorëve. Veprimtaria shkencore-hulumtuese e kandidatit përbëhet nga artikuj shkencorë të botuar në revista shkencore ndërkombëtare, me pjesëmarrje në tubime shkencore të nivelit kombëtarë e ndërkombëtarë. Kjo veprimtari e kandidatit është paraqitur më poshtë.

A. Artikuj shkencorë

1. **RASIMI K**, SEFERI Y, IBRAIMI A, SADIKI F, “*Skew n -Binormal Operators*”, International Journal of Mathematical Analysis, ISSN: 1312-8876, Vol. 13, No. 11, pp. 513 – 517, 2019
2. **RASIMI K**, SEFERI Y, IBRAIMI A, SADIKI F, “*Numerical-Analytical Solution of Nonlinear Fractional-Order Lorenz’s System*”, Applied Mathematical Sciences, ISSN: 1312-885X, Vol. 13, No.13, pp. 595-606, 2019
3. AJREDINI F, GJEVORI A, IZAIRI N, **RASIMI K**, ZAJKOV O, PHET simulation vs real experiments for better understanding electrical resistance, Science and Research, ISSN: 2535 – 0765, Vol. 3, No. 1, pp.35-41, 2019
4. LLESHI F, **RASIMI K**, ISENI E, “*A note on the cluster sets of interpolating Blaschke products*”, Journal of Natural Sciences and Mathematics of UT, ISSN 2545 - 4072, Vol. 3, No. 5-6, pp. 196 - 202, 2018
5. SADIKI F, IBRAIMI A, SEFERI Y, **RASIMI K**, “*Ternary rings and projective planes*” Journal of Natural Sciences and Mathematics of UT, ISSN 2545 - 4072, Vol. 2, No. 4, pp. 172-187, 2017
6. SADIKI F, IBRAIMI A, **RASIMI K**, RUSHITI A, “*Interpretation of Planar Ternary Ring in Desargues Plane Like Usual Ring*” International Journal of Mathematics And its Applications, Vol. 4, No. 3-A, pp.81 – 91, 2016
7. **RASIMI K**, GJOKA L, “*Notes on λ - commuting operators*”, International Journal of Pure and Applied Mathematics (IJPAM), ISSN 1311-8080, Vol. 91, No. 2, 2014
8. DURMISHI E, **RASIMI K**, IBRAIMI A, *Finding a metric for a family of contractive functions*, International J. of Math. Sci. & Engg. Appls. (IJMSEA) ISSN 0973-9424, Vol. 8 No. VI (December, 2014), pp. 181-188S.
9. **RASIMI K**, IBRAIMI A, GJOKA L, “*Some remarks on n -power class(Q) operators*”, International Journal of Pure and Applied Mathematics (IJPAM), ISSN 1311-8080, Vol. 89 No.2, 2013.
10. **RASIMI K**, “*Double Commutativity and Some Results on Quasihyponormal Operators*”, International Journal of Mathematics Research (IJMR), ISSN 0976-5840, Vol. 5, No. 3, 2013.
11. **RASIMI K**, GJOKA L, JUSUFI A, “*On some products of hyponormal and quasihyponormal operators*” 1st International Balkans Conference of Mathematical Sciences”, Elbasan 2013, p.200-203
12. JUSUFI A, IBRAIMI A, **RASIMI K**, “*Drazin’s pseudo-invers for singular matrices with a zero row*” 1st International Balkans Conference of Mathematical Sciences” , Elbasan 2013, p.190-199.
13. JUSUFI A, **RASIMI K**, “*Drazin’s pseudo invers of right angle singular matrix*”, Математички билтен, Vol. 37, No. 1, pp, 49-60, Skopje 2013

B. Tubime shkencore

1. DURMISHI E, SADIKI F, **RASIMI K**, IBRAIMI A, “*Some Almost Integers Generated by Some Pisot Numbers*”, 3rd International Conference of Natural Sciences and Mathematics, 15-17 May, 2019
2. SADIKI F, IBRAIMI A, **RASIMI K**, SEFERI Y, “*Finite Projective Planes and Hamming Codes*”, 3rd International Conference of Natural Sciences and Mathematics, 15-17 May, 2019
3. **RASIMI K**, DEMIRI I, REXHEPI SH, “*Approximations of some mathematical constants based on infinite series*”, 1st International Conference of Natural Sciences and Mathematics, 16-17 June, 2017
4. JUSUFI A, **RASIMI K**, *Pseudo inversi i Drazhinit për matricat joregulare drejtkëndore* Konferenca e Seksionit të Shkencave të Natyrës, Instituti ALB-Shkenca, 1 – 04 Shtator, Prishtinë, 2011
5. **RASIMI K**, GJOKA L, JUSUFI A, “*On some products of hyponormal and quasihyponormal operators*” 1st International Balkans Conference of Mathematical Sciences” May 30-June 1, 2013, Elbasan.
6. **RASIMI K**, IBRAIMI A, GJOKA L., “*Komutativiteti dhe mbyllësia e disa klasa të operatorëve*”, Konferenca e Seksionit të Shkencave të Natyrës-Instituti ALB-Shkenca, Tiranë, 29-31 Gusht, 2013.
7. JUSUFI A, **RASIMI K**, “*Pseudo inversi i Drazin-it për T-matricat joregulare*”, Konferenca e Seksionit të Shkencave të Natyrës, Instituti ALB-Shkenca, 29 – 31 Gusht, Prishtinë, 2014

C. Projekte shkencore

1. **Zbatimi i metodave hulumtuese në mësimdhënien e lëndëve Natyra, Shkencat natyrore dhe shkencat natyrore dhe teknika**, (trajnuet i arsimtarëve nga shkencat e natyrës të shkollave fillore) Projekt i financuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës së Republikës së Maqedonisë, Shkup 2010;
2. **Multilingual Web-based Science Courses**, Tempus project 2006;
3. **Creative Teaching and Learning**, Projekt i financuar nga USAID-i, 2006/2007

D. Përkthime librash (Projekt i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për përkthimin e librave nga universitetet me renome)

1. Lillian Goleniewski, Kitty W. Jarrett, **Telecommunications Essentials, Second Edition: The Complete Global Source** (2nd Edition) , Addison Wesley Professional, 2006
2. Alexander Schrijver, **Theory of linear and integer programming**, John – Wiley & Sons, 1998
3. David F. Rogers, **An Introduction to NURBS With Historical Perspective**, Published by McGraw-Hill, New York 2009;
4. Hassan K. Khalil, **Nonlinear systems**, third edition, Published by Prentice-Hall Inc., New

- York 2002;
5. Thomas R. Kurfess, *Robotics and Automation Handbook*, CRC Press LLC, London, New York, Washington, DC, 2005;
 6. Munson, Young, Okiishi, Huebsch *Fundamentals of Fluid Mechanics*, Sixth Edition, John Wiley & Sons, Inc, 2009
 7. A. E. Fitzgerald, Charles Kingsley Jr, Stephen D. Umans, *Electric Machinery*, Sixth Edition, McGraw-Hill, New York 2003.
 8. Norman S. Nice, “*Control Systems Engineering*”, 5th ed., John Wiley & Sons, Inc, 2008

Në bazë të shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar, komisioni recensues e konstatoi veprimtarinë shkencore-hulumtuese në periudhën paraprake, e cila është e rëndësisë thelbësore për vlerësimin e kandidatit për veprimtarinë shkencore-hulumtuese.

Në përputhje me Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorit në Universitetin e Tetovës (Buletini i universitetit), kandidati Krutan Rasimi ka realizuar gjithsej **52.2 pikë** nga veprimtaria shkencore-hulumtuese dhe ka tejkalluar numrin minimal të pikëve që duhet të tubohen sipas kësaj baze për zgjedhjen në thirrjen profesor inordinar.

IV. VEPRIMTARIA PROFESIONALE-APLIKATIVE

A. Libra të botuar

1. Ibraimi A, Sadiki F, **Rasimi K**, Imeri F, Seferi Y, *Strukturat diskrete I*, Autorët, 2018
2. Sadiki F, Ibraimi A, **Rasimi K**, Seferi Y, Përmbledhje detyrash nga transformimet gjeometrike, Universiteti i Tetovës, 2018
3. Dr. sc. Alit Ibraimi, Mr. sc. Flamure Ibraimi, **Mr. sc. Krutan Rasimi**, *Algjebra lineare me detyra të zgjidhura* (dispensë), Tetovë 2012;

B. Redaktime profesionale

1. Lillian Goleniewski, Kitty W. Jarrett, *Telecommunications Essentials, Second Edition: The Complete Global Source* (2nd Edition) , Addison Wesley Professional, 2006 (Libër i përkthyer nga gjuha angleze në gjuhën shqipe – Projekt i financuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë)
2. Alexander Schrijver, Theory of linear and integer programming, John – Wiley & Sons, 1998 (Libër i përkthyer nga gjuha angleze në gjuhën shqipe – Projekt i financuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë)
3. Marc Meyers and Krishan Chawla, *Mechanical Behavior of Materials*, Second Edition, Cambridge University Press, 2009 (Libër i përkthyer nga gjuha angleze në gjuhën shqipe – Projekt i financuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë)
4. S.M. Allen, E.L.Thomas, *The Structure of Materials*, Wiley 1998, (Libër i përkthyer nga gjuha angleze në gjuhën shqipe – Projekt i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë)
5. Stephen D. Senturia, *Microsystem Design*, Kluwer Academic Publisher, Dordrecht, 2002; (Libër i përkthyer nga gjuha angleze në gjuhën shqipe – Projekt i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë)
6. Munson, Young, Okiishi, Huebsch, *Fundamentals of Fluid Mechanics*, Sixth Edition, John Wiley & Sons, Inc, 2009 (Libër i përkthyer nga gjuha angleze në gjuhën shqipe – Projekt i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë)
7. A. E. Fitzgerald, Charles Kingsley, Jr, Stephen D. Umans, *Electric Machinery*, Sixth Edition, McGraw-Hill, New York 2003 (Libër i përkthyer nga gjuha angleze në gjuhën shqipe – Projekt i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë)
8. Norman S. Nice, *“Control Systems Engineering”*, 5th ed., John Wiley & Sons, Inc, 2008 (Libër i përkthyer nga gjuha angleze në gjuhën shqipe – Projekt i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë)

C. Recensent librash për shkolla të mesme ose fillore

Kandidati Krutan Rasimi është recensent i disa teksteve mësimore dhe fletoreve të punës për matematikën e shkollës fillore. Konkretisht, ai është recensent i teksteve mësimore dhe fletoreve të punës për matematikë nga klasa e parë deri te klasa e gjashtë në gjuhën shqipe dhe atë maqedone.

Në përputhje me Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorit të Universitetit të Tetovës (Buletini i universitetit), kandidati Krutan Rasimi ka realizuar gjithsej **32 pikë** nga veprimtaria profesionale-aplikative dhe e ka kaluar numrin minimal të pikëve që duhet të tubohen sipas kësaj baze për zgjedhjen në thirrjen profesor inordinar.

V. VEPRIMTARIA NGA INTERESI MË I GJERË

- Koordinator i fakultetit për studimeve e ciklit të parë
- Anëtar i komisionit regjistruar të fakultetit
- Anëtar i komisionit për transfer të studentëve
- Anëtar i komisionit universitar për regjistrimin e studentëve
- Anëtar i Senatit të universitetit
- Anëtar i komisionit të MASH-it për vlerësimin e kandidatëve për drejtorë të shkollave të mesme dhe fillore si dhe institucioneve tjera edukative
- Bashkëpunëtor i jashtëm i Qendrës Shtetërore të Provimeve për testimin ekstern të nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme

Në përputhje me Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorit në Universitetin e Tetovës (Buletini i universitetit), kandidati Krutan Rasimi ka realizuar gjithsej **16.00 pikë** nga veprimtaritë me interes më të gjerë dhe e ka kaluar numrin minimal të pikëve që duhet të tubohen sipas kësaj baze për zgjedhjen në thirrjen profesor inordinar.

VI. FORMULARI PËR RAPORTIN PËR ZGJEDHJE NË THIRRJEN MËSIMORE-SHKENCORE

Në shtojcë është bashkangjitur formulari për raportin e zgjedhjes në thirrjen mësimore-shkencore. Kandidati Krutan Rasimi ka grumbulluar gjithsej **199.08 pikë**, edhe atë për: veprimtarinë mësimore-arsimore **98.88 pikë**, veprimtarinë shkencore-hulumtuese **52.2 pikë**, veprimtarinë profesionale-aplikative **32 pikë** dhe veprimtaritë me interes më të gjerë **16 pikë**.

REFERENCAT PROFESIONALE TË KANDIDATIT PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJE	Pikë
VEPRIMTARIA MËSIMORE-SHKENCORE	98.88
VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE	52.20
VEPRIMTARIA PROFESIONALE-APLIKATIVE	32.00
VEPRIMTARITË ME INTERES MË TË GJERË	16.00
Gjithsej	199.08

PËRFUNDIMI DHE PROPOZIMI

Në bazë të pasqyrës të prezantuar më lart si dhe nga të dhënat në **Shtojcë**, komisioni Recensues i vlerëson pozitivisht aktivitetet në veprimtaritë mësimore-arsimore, shkencore-hulumtuese, profesionale-aplikative dhe veprimtarinë me interes më të gjerë dhe konstaton se kandidati Krutan Rasimi në përputhje me Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorit në Universitetin e Tetovës (Buletini i universitetit), ka tubuar gjithsej **199.08 pikë** nga referencat profesionale dhe me këtë e ka kaluar numrin minimal të pikëve që duhet të realizohen për zgjedhjen në thirrjen mësimore-shkencore **profesor inordinar**.

Duke u bazuar në të dhënat e mësipërme për aktivitetin e përgjithshëm të kandidatit, Komisioni përfundon se Krutan Rasimi ka kualitet shkencor dhe profesional dhe sipas ligjit për arsim të lartë si dhe në përputhje me Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorit në Universitetin e Tetovës i plotëson të gjitha kushtet që të zgjidhet në thirrjen që ka konkurruar.

Komisioni Recensues ka nderin dhe kënaqësinë t'i propozojë Këshillit mësimor – shkencor të Fakultetit të Shkencave Matematike – Natyrore të Universitetit të Tetovës që kandidati Krutan Rasimi të zgjidhet në thirrjen mësimore-shkencore **PROFESOR INORDINAR** për lëndët **Hapësirat metrike, Masa dhe Integrali** dhe **Analiza komplekse** (në programin studimor Matematikë).

Tetovë, 9.06.2020

ANËTARËT E KOMISIONIT RECENSUES:

1. **Prof. dr. Risto Malçeski**, kryetar

2. **Prof. dr. Biljana Krsteska**, anëtar

3. **Prof. Dr. Alit Ibraimi**, anëtar

S H T O J C Ë

PËR RECENSIONIN PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJEN MËSIMORE-SHKENCORE, SHKENCORE DHE MËSIMORE-PROFESIONALE

Kandidati: Krutan Sadik Rasimi
(emri, emri i prindit dhe mbiemri)

Institucioni: Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore – UT, Tetovë
(emri i fakulteti/institucionit)

Lëmia shkencore: Matematikë

I. VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE

Nr. rendor	Emri i aktivitetit:	Pikët
I.1	Mbajtja e ligjeratave (lëndë nga cikli i parë dhe i dytë)	73.5
	Analizë matematike I (në fizikë) (3+3), 5 semestra	$5 \times 15 \times 3 \times 0.04 = 9$
	Analizë matematikë II (në fizikë) (3+3), 5 semestra	$5 \times 15 \times 3 \times 0.04 = 9$
	Metoda matematike në fizikë I (3+3), 5 semestra	$5 \times 15 \times 3 \times 0.04 = 9$
	Masa dhe integrali (3+2), 5 semestra	$5 \times 15 \times 3 \times 0.04 = 9$
	Analizë komplekse (4+3), 5 semestra	$5 \times 15 \times 4 \times 0.04 = 12$
	Algjebër lineare (në fizikë) (2+2), 5 semestra	$5 \times 15 \times 2 \times 0.04 = 6$
	Hapësirat metrike (2+2), 5 semestra	$5 \times 15 \times 2 \times 0.04 = 6$
	Hyrje në topologji (2+2), 5 semestra	$5 \times 15 \times 2 \times 0.04 = 6$
	Analizë funksionale (2+2), 5 semestra	$5 \times 15 \times 2 \times 0.05 = 7.5$
I.2	Përgatitja e lëndëve të reja (ligjerata)	9
	Analizë matematike I	1
	Analizë matematikë II	1
	Metoda matematike në fizikë I	1
	Masa dhe integrali	1
	Analizë komplekse	1
	Algjebër lineare	1
	Hapësirat metrike	1
	Hyrje në topologji	1
	Analizë funksionale	1
I.3	Konsultime me studentë	1.46
	Analizë matematike I (në fizikë) (3+3), 5 semestra	$6 \times 5 \times 0.002 = 0.06$
	Analizë matematikë II (në fizikë) (3+3), 5 semestra	$6 \times 5 \times 0.002 = 0.06$
	Metoda matematike në fizikë I (3+3), 5 semestra	$5 \times 5 \times 0.002 = 0.05$
	Masa dhe integrali (3+2), 5 semestra	$30 \times 5 \times 0.002 = 0.3$
	Analizë komplekse (4+3), 5 semestra	$15 \times 5 \times 0.002 = 0.15$
	Algjebër lineare (në fizikë) (2+2), 5 semestra	$6 \times 5 \times 0.002 = 0.06$
	Hapësirat metrike (2+2), 5 semestra	$20 \times 5 \times 0.002 = 0.2$
	Hyrje në topologji (2+2), 5 semestra	$30 \times 5 \times 0.002 = 0.3$
Analizë funksionale (2+2), 5 semestra	$20 \times 5 \times 0.002 = 0.2$	
I.4	Mentor i punimeve të diplomës	$15 \times 0.2 = 3$
I.5	Anëtar i komisionit për vlerësim ose mbrojtje të punimit të diplomës	$15 \times 0.1 = 1.5$
I.6	Anëtar i komisionit për vlerësim ose mbrojtje të punimit të magistraturës	$15 \times 0.3 = 4.5$
I.7	Tekst universitar pozitivisht i recenzuar (bashkëautor)	6
I	Gjithsej(I.1 – I.7)	98.88 pikë

II. VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE

Nr. rendor	Emri i aktivitetit:	Pikët
II.1	Mentor punimesh të magjistraturës	10×2 = 20
	Artikuj me rezultate shkencore/profesionale origjinale, të publikuara në revistë referente shkencore/profesionale me bord redaktues ndërkombëtar	18
	1. RASIMI K , SEFERI Y, IBRAIMI A, SADIKI F, “ <i>Skew n-Binormal Operators</i> ”, International Journal of Mathematical Analysis, ISSN: 1312-8876, Vol. 13, No. 11, pp. 513 – 517, 2019	3
	2. RASIMI K , SEFERI Y, IBRAIMI A, SADIKI F, “ <i>Numerical-Analytical Solution of Nonlinear Fractional-Order Lorenz’s System</i> ”, Applied Mathematical Sciences, ISSN: 1312-885X, Vol. 13, No.13, pp. 595-606, 2019	3
II.2	3. AJREDINI F, GJEVORI A, IZAIRI N, RASIMI K , ZAJKOV O, PHET simulation vs real experiments for better understanding electrical resistance, Science and Research, ISSN: 2535 – 0765, Vol. 3, No. 1, pp.35-41, 2019	3
	4. LLESHI F, RASIMI K , ISENI E, “ <i>A note on the cluster sets of interpolating Blaschke products</i> ”, Journal of Natural Sciences and Mathematics of UT, ISSN 2545 - 4072, Vol. 3, No. 5-6, pp. 196 - 202, 2018	3
	5. SADIKI F, IBRAIMI A, SEFERI Y, RASIMI K , “ <i>Ternary rings and projective planes</i> ” Journal of Natural Sciences and Mathematics of UT, ISSN 2545 - 4072, Vol. 2, No. 4, pp. 172-187, 2017	3
	6. SADIKI F, IBRAIMI A, RASIMI K , RUSHITI A, “ <i>Interpretation of Planar Ternary Ring in Desargues Plane Like Usual Ring</i> ” International Journal of Mathematics And its Applications, Vol. 4, No. 3-A, pp.81 – 91, 2016	3
	Artikuj me rezultate shkencore/profesionale origjinale, të publikuara në librin e përmbledhjeve të punimeve të konferencës shkencore/profesionale m	4.2
II.3	1. DURMISHI E, SADIKI F, RASIMI K , IBRAIMI A, “ <i>Some Almost Integers Generated by Some Pisot Numbers</i> ” Journal of Natural Sciences and Mathematics of UT, ISSN 2545 - 4072, Vol. 4, No. 7-8, pp. 163-167, 2019	1.2
	2. SADIKI F, IBRAIMI A, RASIMI K , SEFERI Y, “ <i>Finite Projective Planes and Hamming Codes</i> ” Journal of Natural Sciences and Mathematics of UT, ISSN 2545 - 4072, Vol. 4, No. 7-8, pp. 210 - 216, 2019	1.2
	3. JUSUFI A, RASIMI K , “ <i>Pseudo Drazin invers for Singular real T matrices</i> ”, Journal of Natural Sciences and Mathematics of UT, ISSN 2545 - 4072, Vol. 1, No. 2-3 pp. 24-34, 2016	1.8
II.4	Përkthim librash nga gjuha angleze në gjuhën shqipe (Nga Projekti i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për përkthimin e librave nga Universitetet e renomuara)	10
	1. Lillian Goleniewski, Kitty W. Jarrett, <i>Telecommunications Essentials, Second Edition: The Complete Global Source</i> (2nd Edition) , Addison Wesley Professional, 2006	5
	2. Alexander Schrijver, <i>Theory of linear and integer programming</i> , John – Wiley & Sons, 1998	5
II	Gjithsej (II.1-II-4)	52.2

III. VEPRIMTARI PROFESIONALE-APLIKATIVE

Nr. rendor	Emri i aktivitetit:	Pikët
III.1	Libra nga fusha profesionale (bashkëautor)	14
	1. Ibraimi A, Sadiki F, Rasimi K , Imeri F, Seferi Y, <i>Strukturat diskrete I</i> , Autorët, 2018	7
	2. Sadiki F, Ibraimi A, Rasimi K , Seferi Y, Përmbledhje detyrash nga transformimet gjeometrike, Universiteti i Tetovës, 2018	7
III.2	Redaktim profesional i librit të përkthyer nga gjuha angleze në gjuhën shqipe (nga Projekti i Qeverisë së RM për përkthim librash nga universitetet e renomuar)	6
	1. Lillian Goleniewski, Kitty W. Jarrett, <i>Telecommunications Essentials, Second Edition: The Complete Global Source</i> (2nd Edition) , Addison Wesley Professional, 2006	3
	2. Alexander Schrijver, Theory of linear and integer programming, John – Wiley & Sons, 1998	3
III.3	Recenzent librash shkollash fillore ose të mesme (12 tekse dhe 12 përmbledhje të matematikës për shkollën fillore për klasat nga e I deri e VI)	24×0.5=12
III	Gjithsej (III.1-III.2):	24

IV. VEPRIMTARITË ME INTERES MË TË GJERË

Nr. rendor	Emri i aktivitetit:	Pikët
IV.1	Koordinator i studimeve të ciklit të parë	2
IV.2	Anëtar komisioni fakulteti	4
IV.3	Anëtar komisioni universitar	7
IV.4	Pjesëmarrje në komisione dhe trupa tjera organesh shtetërore	1
IV.5	Anëtar senati	2
IV	Gjithsej (IV.1-IV.3):	16

REFERENCAT PROFESIONALE TË KANDIDATIT PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJE	Pikët
VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE	98.88
VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE	52.20
VEPRIMTARIA PROFESIONALE-APLIKATIVE	32.00
VEPRIMTARITË ME INTERES MË TË GJERË	16.00
Gjithsej	199.08

Tetovë, 9.06.2020

ANËTARËT E KOMISIONIT RECENSUES:

1. Prof. Dr. Risto Malçeski, kryetar

2. Prof. Dr. Biljana Krsteska, anëtar

3. Prof. Dr. Alit Ibraimi, anëtar

Tetovë, 08.06.2020

REFERAT

për zgjedhjen e një mësimdhënësi në thirrjen mësimore-shkencore profesor inordinar për lëndët inteligjencë artificiale, inxhinieri softuerike, statistikë mjekësore me informatikë (Fakulteti i shkencave të mjekësisë) në Fakultetin e shkencave matematike natyrore në Universitetin e Tetovës

Në bazë të nenit 166 të Ligjit për arsimin e lartë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 82/2018), Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës si dhe në mbështetje të nenit 144 të Statutit të Universitetit të Tetovës dhe në bazë të propozim-vendimit (nr. 15-594/1) nga mbledhja e mbajtur më 29.05.2020 të katedrës së Programit studimor Informatikë, Këshilli Mësimor-Shkencor i Fakultetit të Shkencave Matematike - Natyrore në lidhje me konkursin e shpallur për zgjedhje-rizgjedhje të shpallur me datën 18.05.2020 në Gazetën “Koha”, “Nova Makedonija” dhe Ueb faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës, më 01.06.2020 sjell: Vendimin (nr. 15-605/1) për formimin e Komisionit recensues. Formohet Komisioni për zgjedhje-rizgjedhje të një mësimdhënësi për lëndët **Inteligjencë artificiale, Inxhinieri softuerike, Statistikë mjekësore me informatikë (Fakulteti i shkencave të mjekësisë)**, në përbërje:

- 1. Prof. Dr. Zamir Dika, Profesor Ordinar – kryetar**
- 2. Prof. Dr. Ivan Çorbev, Profesor Ordinar -anëtar**
- 3. Prof. Dr. Florim Idrizi, Profesor Inordinar -anëtar**

Në konkursin e shpallur në gazetën “Koha” dhe “Nova Makedonija” dhe Ueb faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës më datë 18.05.2020 për zgjedhjen e mësimdhënësit në thirrjen mësimore-shkencore Inteligjencë artificiale, Inxhinieri softuerike dhe Statistikë mjekësore me informatikë (në Fakultetin e Shkencave të Mjekësisë) u paraqit vetëm një kandidat,

Doc. Dr. Festim Q. Halili - i punësuar në marrëdhënie të rregullt pune në Programin studimor Informatikë, Fakulteti i Shkencave Matematike - Natyrore, në Universitetin e Tetovës.

Komisioni, pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga kandidati në fjalë, Këshillit Mësimor – Shkencor të Fakultetit të Shkencave Matematike - Natyrore dhe Këshillit të Rektoratit, i paraqet këtë:

RECENSION

Për zgjedhje – rizgjedhje të një mësimdhënësi për lëndët Inteligjencë artificiale, Inxhinieri softuerike dhe Statistikë mjekësore me informatikë (në Fakultetin e Shkencave të Mjekësisë), pranë Fakultetit të Shkencave Matematike - Natyrore në Universitetin të Tetovës.

I. TË DHËNA BIOGRAFIKE DHE ZHVILLIMI PROFESIONAL

A. Shënime biografike të kandidatit

Doc. Dr. Festim Qazim Halili ka lindur më 05.05.1984 në Tetovë. Shkollën fillore e kreu në Sh.f. “Naim Frashëri” të Tetovës duke arritur sukses prej 5.00 në të gjitha vitet e shkollimit dhe duke qenë pjesëmarrës në shumë gara komunale dhe republikane, ku edhe arriti të merr çmime të rëndësishme në nivel shkollor, komunal dhe shtetëror si në: astronautikë (vendi i parë – nivel komunal), meteorologji (vendi i tretë – nivel republikan), histori (vendi i tretë – nivel republikan), me ç’rast Ministria e Arsimit dhe Shkencës i ndau bursë meritore për katër vite të shkollës së mesme.

Në vitin 1999 regjistrohet në gjimnazin e Tetovës në drejtimin Matematiko-natyror, ku për katër vite arrin mesataren 5.00. Edhe gjatë kësaj periudhe karakterizohet me shumë aktivitete jashtë shkollore, duke u kyçur në disa organizata joqeveritare të vendit, si dhe në klubin e debatit të qytetit dhe në trajnime të ndryshme për lidershhip.

Në vitin 2003 regjistrohet në Universitetin e Evropës Juglindore në Fakultetin e Shkencave Bashkëkohore dhe Teknologjitë në drejtimin e Shkencave kompjuterike. Përgjatë studimeve fiton bursën prestigjioze nga Fondacioni Gjerman DAAD, ku edhe qëndron për studime semestrale në Universitetin Teknik të Minhenit. Njëkohësisht i vazhdohet bursa nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës edhe për katër vite të tjera. Gjatë studimeve zgjidhet edhe si kandidat garues i fakultetit për kryetar të Unionit të studentëve. Më pas merr pjesë në punëtoritë për promovim të paqes në Zvicër, ndërsa në Marsej të Francës tregon sukses në seminarin multimedial. Në vitin 2007 mbaron studimet me mesatare 9.4.

Në vitin 2007 u regjistrua në studimet pasuniversitare në Universitetin e Evropës Juglindore, në Fakultetin e Shkencave Bashkëkohore dhe të Teknologjisë në drejtimin Zhvillimi i Softuerit dhe Aplikacioneve. Temën e magjistraturës me titull “Analiza dhe krahasimi i ueb shërbimeve, arkitektura e tyre si dhe implementimi praktik në një ueb udhëzues turistik” e mbrojti me sukses më 06.07.2011 me notë mesatare 9.6 dhe mori titullin Magjistër i Shkencave Kompjuterike. Vlen të theksohet se nga sukcesi permanent, ai arriti që të merr përsëri bursë gjatë studimeve të masterit nga MASH.

Nga 17.8.2009 është angazhuar në Universitetin e Tetovës si asistent i ri në Programin studimor të Informatikës dhe i angazhuar në qendrën e Teknologjisë Informatike, më pas në vitin 2012 merr thirrjen bashkëpunëtor (Asistent), ku i ka mbajtur ushtrimet në këto lëndë: Inteligjencë artificiale, Inxhinieri softuerike, Bazat e të dhënave, Statistikë mjekësore me Informatikë (në Fakultetin e Shkencave të Mjekësisë), E-Biznes (në fakultetin Ekonomik dhe në programin studimor Informatikë), Hyrje në programim (në programin studimor Matematikë për financa dhe biznes), Informatikë 1 dhe 2 (në Gjuhë dhe Letërsi gjermane dhe italiane).

Në vitin 2011 Festim Q. Halili u regjistrua në studime të doktoraturës dhe teza e doktoraturës mban titullin “Aplikimi i koreografisë së ueb shërbimeve në sistemet heterogjene të

informacionit”, të cilën e mbrojti me sukses të shkëlqyeshëm më 10.12.2014 dhe e mori titullin Doktor i shkencave të informatikës në Universitetin e Tiranës, Republika e Shqipërisë. Përgjatë studimeve të doktoratës, ai fiton bursë nga British Scholarship Trust dhe qëndron për studime specializimi në Royal Holloway University of London, ku nën mentorim të dekanit të Fakultetit të Shkencave Kompjuterike Prof. Dr. Jose Luis Fiadeiro tregon aftësi të larta hulumtuese shkencore. Në gusht të vitit 2015 zgjidhet në thirrjen mësimore-shkencore Docent në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore, në programin studimor Informatikë pranë UT-së. Njëherit, nga janari i vitit 2014 deri në prill të vitit 2016 ka qenë udhëheqës i Zyrës për Përpilim dhe menaxhim me projekte në rektoratin e UT-së, me ç’rast u fitua grant nga Delegacioni Evropian i IPA-CBC fondeve, me temë të biodiversitetit të Malit Sharr. Festimi, si kryetar komisioni i emëruar nga universiteti, në bashkëpunim me Google, me sukses realizuan hakatonin e parë në Universitetin e Tetovës, me pjesmarrës nga shumë universitete. Një sukses tjetër do të jetë roli i udhëheqësit dhe të bordit shkencor për menaxhimin dhe organizimin e konferencës së IEEE me pjesmarrës nga shumë vende të botës.

Në prill të vitit 2016 emërohet si Zv. Kryeministër në Sekretariatit për zbatimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë të Veriut, detyrë të cilën e ushtroi deri më qershor të vitit 2017, ku ndihmoi në themelimin e fakulteteve të reja dhe krijimin e 130 vendeve të reja të punës pranë UT-së.

Nga tetori i 2019 ushtron detyrën e drejtorit gjeneral të NP për Infrastrukturë Hekurudhore – Hekurudhat e Republikës së Maqedonisë të Veriut – Shkup.

Vlen të theksohet se Festim Halili është i angazhuar si ligjërues vizitues edhe në universitetin austriak FH Technikum Wien, ku ligjëron në studimet e ciklit të dytë (master) lëndët: AI - Prolog dhe Service Oriented Computing.

Njëherit, në cilësinë e profesorit vizitues ka ligjëruar në universitete të ndryshme si në: Lithuania Business University of Applied Sciences (Lituanë), University of Craiova (Rumani), University of Pannonia dhe University of Szeged (Hungari), University of Sarajevo (Bosnjë), University of Business and Technology (Kosovë), University of New York Tirana (Shqipëri) dhe South East European University dhe IBU (Maqedoni e Veriut).

Si NCP (Qendra e Kontaktit kombëtar) ka marr pjesë në takime të shumta për hartime të strategjive arsimore-shkencore të organizuara nga Bashkimi Evropian si në Limassol të Qipros, Bruksel të Belgjikës. Njëherit, si anëtar i Bordit të Akreditimit dhe Evaluimit në vend ka ndihmuar në përpilimin e koncepteve kualitative të programeve studimore të universiteteve të vendit tonë. Gjithashtu, është anëtar i Forumit Digjital të Maqedonisë së Veriut ku ndihmon në hartimet e strategjive teknologjike dhe softuerike të vendit tonë. Ka qenë nënkryetar i bordit të agjencionit MARNET, ku janë hartuar strategji të menaxhimit të domeneve dhe rrjeteve optike të institucioneve në vendin tonë.

B. Puna arsimore-pedagogjike dhe marrja e thirrjeve mësimore

- Në vitin 2005 – fiton bursën prestigjioze nga fondacioni gjerman DAAD dhe vazhdon studimet në Universitetin Teknik të Mynihut, ku edhe mbaron semestrin me nota maksimale.
- Në vitin akademik 2008-2009 u angazhua mësimdhënëse i informatikës në shkollën fillore Kirili dhe Metodij në Tetovë.

- Në vitet 2008/2010 – u angazhua si konsulent në Kompaninë gjermane për telekomunikacion Inacon GmbH.
- Në vitin akademik **2009 - 2012**: u angazhua asistent i ri në programin studimor të informatikës në FSHMN për lëndët: e-Biznes, Inteligjencë artificiale, Bazat e të dhënave, Teknologji të informacionit, Inxhinieri softuerike, si dhe zyrtar në qendrën për Teknologji të Informacionit për mirëmbajtje të rrjetit dhe zhvillim të aplikacioneve softuerike në Rektorat.
- Në vitin akademik 2012/2013 – u angazhua ligjërues në programin e trajnimit të qytetarëve në suaza të projektit të Ministrisë së Shoqërisë Informatike dhe Administratës.
- Në vitin **2012** – zgjidhet në thirrjen mësimore-shkencore asistent (bashkëpunëtor) në programin studimor informatikë në FSHMN në Universitetin e Shtetëror të Tetovës.
- Në vitin 2013 – fiton bursën prestigjioze nga fondacioni British Scholarship Trust, ku vijon hulumtimet shkencore të doktoraturës në Fakultetin e shkencave kompjuterike në Royal Holloway University of London.
- Nga viti 2014 – ligjëron në UNB lëndë si Ueb dizajn dhe multimedia, Dizajnimi dhe menaxhimi i bazave të të dhënave dhe Struktura e të dhënave.
- Nga viti 2014/2016 – shef i zyrës për Përpilim dhe menaxhim me projekte në rektorat të UT-së.
- Nga viti 2014/2015 – zgjidhet ligjërues për çertifikim të drejtorëve të shkollave fillore dhe të mesme për modulën e parë.
- Në vitin **2015** - zgjidhet në thirrjen mësimore-shkencore Docent në programin studimor informatikë në FSHMN në Universitetin Shtetëror të Tetovës.
- Në vitin 2015 – në Northern Illinois University të SHBA-së kompletton programin për Lidership të SHBA-ve dhe gjuhës angleze.
- Në vitin 2016/2017 – ligjëron në UBT në Kosovë në katedrën e sistemeve të informacionit.
- Në vitin 2017/2018 – angazhohet ligjërues i jashtëm në Universitetin e Shkencave të Zbatuara (FH Technikum Wien) në Austri, ku ligjëron në master Inteligjencën artificiale me Prolog dhe Service Oriented Computing.
- Në tetor të vitit 2018 – ligjëron në Lituani, në Lithuania Business of Applied Sciences, nëpërmjet të programit Erasmus+.
- Në dhjetor të vitit 2018 – ligjëron në Hungari, në Universitetin Pannonia, në Fakultetin e teknologjisë së informacionit.
- Në mars të vitit 2019 – ligjëron në universitetin e Kraiovës në Fakultetin e automatikës, kompjuterëve dhe elektronikës në Rumani.
- Në prill të vitit 2019 – ligjëron në Universitetin Szeged në Hungari.
- Në shtator të vitit 2019 – ligjëron në Bosnjë dhe Hercegovinë në Universitetin e Sarajevës, në Fakultetin e inxhinierisë mekanike.
- Në vitin 2019 – merr çertifikatë të gjuhës angleze Bulats, ndërsa më herët edhe atë të TOEFL.
- Në vitin akademik 2019 – merr pjesë në cilësinë e përfaqësuesit shkencor të Maqedonisë së Veriut në takime të Horizon Europe programit në Qipro dhe Belgjikë.

II. Veprimtaria mësimore-arsimore

A. Ligjërata në universitete, shkolla dhe punëtori (Pas marrjes së thirrjes docent)

- Inteligjencë artificiale në programin studimor informatikë
- Inxhinieri softuerike në programin studimor informatikë
- E- Biznes në programin studimor informatikë
- Statistikë mjekësore me informatikë – në programin studimor Mjekësi e përgjithshme në FSHM.
- Bazat e të dhënave – në programin studimor Gjeodezi dhe Gjeoinformatikë
- Informatikë – gjuhë dhe letërsi gjermane
- Hyrje në programim – në programin studimor Matematikë financiare
- Bazat e informatikës – në programin studimor Grafikë dhe dizajn në Fakultetin e Arteve
- Strukturë të dhënash – në programin studimor inxhinieri kompjuterike në Universitetin Ndërkombëtar Ballkanik.
- Dizajnim dhe menaxhim i bazave të të dhënave - në programin studimor inxhinieri kompjuterike në UNB.
- Teknologjitë e uebit – në programin studimor informatika e biznesit në Universiteti i Evropës Juglindore.
- Projekt në SI – në programin studimor Sistemet e informacionit në Universiteti për Biznes dhe Teknologji.
- Ueb Dizajn – në shkenca kompjuterike në Universiteti Ndërkombëtar i Strugës.
- Inxhinieri Softuerike – në shkenca kompjuterike në UNS.

Mbajtja e ligjëratave në ciklin e dytë të studimeve

- Inteligjencë Artificiale me Prolog – në shkenca kompjuterike në FH Technikum Wien në Austri.
- Arkitektura e Orientuar në Shërbime – në programin studimor informatikë UT
- Inteligjenca Artificiale e Avancuar – në programin studimor informatikë UT
- Emerging Trends in Information Systems – në programin studimor Biznes-Informatikë UEJL.
- Database Systems – në programin studimor inxhinieri kompjuterike në UNB.
- Siguria e Bazave të të dhënave – në programin studimor sisteme të informacionit UBT.

B. Mentorime dhe recensione

Doc. Dr. Festim Halili me sukses dhe përkushtim ka udhëhequr (mentoruar) numër të konsiderueshëm punimesh diplome si në ciklin e parë po ashtu edhe në ciklin e dytë, si dhe të punimeve shkencore, të reflektuara në Shtojcë.

Kandidati në fjalë ka qenë anëtar i komisioneve recensuese për zgjedhje-rizgjedhje në tituj. Ai gjithashtu ka dhënë mendim në vlerësimin e punimeve të magistraturës të disa kandidatëve.

C. Botim i librit universitar të recensuar pozitivisht:

- Libri “Inxhinieri Softuerike – njehsim i prirur drejt shërbimit”

D. Përgaditja e lëndës së re

- Përgaditje e ligjëratave për lëndët në ciklin e dytë (master): Arkitektura e orientuar në shërbime, Inteligjenca artificiale e avancuar, IA me Prolog, Emerging Trends in Information Systems dhe Teknologjitë e Uebit (në studime të ciklit të parë).

E. Dispenca interne për ligjërata

1. Festim Halili, “Modelime softuerike” – për studentët e drejtimit të Informatikës,
2. Festim Halili, “Arkitektura e orientuar në shërbime” – për Informatikanë.

F. Recensentë të botimit universitar, si dhe recensentë i punimit në fushën e veprimit mësimor-arsimor

- Libri i Basri Ahmedit “Baza të Informatikës dhe Teknologji Informacioni” – Recensent.
- Recensent i punimit “Internet of things and Customer Benefits” nga Fontanari Martin, Sotrkel Marcus, et.al, në VADYBA Journal of Management ISSN 1648-7974
- Recensent i punimit “Performance Investigation of Classification Algorithms for 'diabetes Data' Prediction” nga Gera Victor Daniel, et.al, në CIMSIM2015, etj.

H. Anëtar i komisionit të garave studentore

Google Hackathon organizuar në UT me titull “Google your future”.

Në përputhje me Rregulloren për kriteret dhe procedurën e zgjedhjes në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe bashkëpunëtor në Universitetin e Tetovës (Buletini i universitetit), kandidati Doc. Dr. Festim Q. Halili ka realizuar gjithsej **245.366** pikë nga veprimtaria mësimore arsimore.

III. VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE

Krahas angazhimit në procesin mësimor, kandidati është angazhuar vazhdimisht në hulumtime shkencore në lëmin e informatikës. Veprimtaria shkencore-hulumtuese e kandidatit përbëhet nga artikujt shkencorë të botuar në revista shkencore ndërkombëtare, me pjesëmarrje në konferenca shkencore ndërkombëtare të përkrahura dhe/ose të indeksuara IEEE, AICIT, Scopus, Scimago, Web of Science, Ebsco dhe pjesëmarrje në projekte të ndryshme. Kjo veprimtari e kandidatit është paraqitur si vijon:

A. Revista Shkencore:

1. **F. Halili** and L. Koraqi, "The security aspects of applications in Kosovo companies" in Modern Applied Science, Vol.13, No.1, ISSN: 1913-1844, pp. 221 – 226, Published by Canadian Center of Science and Education, January 2019, Canada.
2. **F. Halili**, B. Jashari and G. Haxhijaj, "Use of mobile banking in Kosovo – challenges and priorities", in Advances in Information Sciences and Service Sciences, publisher: AICIT Advanced Institute of Convergence Information Technology, March 2019, South Korea.
3. E. Ramadani, **F. Halili** and F. Idrizi, "Tailored Dijkstra and Astar algorithms for shortest path Softbot roadmap in 2D grid in a sequence of tuples", in International Journal of Science and Engineering Investigations, vol.8, issue 92, September 2019.
4. H. Halimi, F. Idrizi, **F. Halili** and B. Baftijari, "An Efficient Algorithm for Energy Management in Smart Home including Renewable energy", in International Journal of Computer Science and Telecommunication, vol. 10, issue 6, December 2019, ISSN: 2047-3338.
5. **F. Halili**, F. Idrizi, I. Bilal Devlez and H. Halimi, "Data Mining functionality and usage areas", in Journal of Natural Sciences and Mathematics of UT, vol.4, no. 7-8, 2019, UCD:004.659-049.8.
6. **F. Halili**, E. Blakaj and S. Blakaj, "Service-Oriented Architecture in Automation Industries", in International Journal of Computers & Technology, vol 19 (2019) ISSN:2277-3061 pp.7493-7501.
7. **F. Halili**, S. Kamberi and M. Kasa Halili, "Towards the Cloud Deployment of a Heterogeneous Service Oriented System", in Journal of Applied Mathematics and Computation, pp.42-50, Vol.2, No.2, ISSN: 2576-0653, Hill Publishing Group, February 2018, USA.
8. **F. Halili** and L. Koraqi, "Social Media Testing with Selenium", in International Journal of Science and Engineering Investigations, vol. 7, issue 80, September 2018, ISSN: 2251-8843
9. **F. Halili** and F. Kamberi, "Performance analysis of classification Algorithms: A case study of Naive Bayes and J48 in Big Data", in Journal of Applied Mathematics and Computation, pp. 50-58, Vol.2, No.2, ISSN: 2576-0653, Hill Publishing Group, February 2018, USA.
10. **F. Halili** and E. Ramadani, "Web Services: A Comparison of SOAP and REST Services", in Journal of Modern Applied Science, Vol.12, No.3, pp.175-183, ISSN: 1913-1844, Published by Canadian Center of Science and Education, March 2018, Canada.
11. **F. Halili**, E. Rufati, et.al, "Towards REST verbs dedicated to advanced information systems", in Journal of Natural Sciences and Mathematics of UT, Vol.3 No.5-6, 2018.
12. B. Fetaji, **F. Halili**, M. Fetaji and M. Ebibi, "Semantic Security Analyses of Web Enabled Databases using SQL injection, International Journal of Convergence Technology (JCIT), Volume 11, No 4, Sep.2016, ISSN 19759320, 22339299.
13. B.Rahmani, F.Idrizi and **F.Halili**, "An Analysis of Development of E-Government In Macedonia and Creating a Mobile Application for the Secretariat for European Affairs", International Journal on Information Technologies & Security, Vol. 8, Issue 2, pp.15-22, ISSN 1313-8251.
14. L. Spahija and **F. Halili**, "Review of Web Service Processes", in international e-journal Dimorian Vol-4, Issue 5, pp.24-32 Sept-Oct 2017, eissn:2394-9163.
15. L. Spahija and **F. Halili**, "Web Services State of the Art", in Journal of Natural Sciences and Mathematics of UT, Vol.2, No.3, pp.74-79, UDC:5, ISSN 2545-4072, March 2017.
16. **Festim Halili**, Avni Rustemi, "Predictive Modeling: Data Mining Regression technique applied in prototype", International Journal of Computer Science and Mobile Computing, IJCSMC, Vol.5 Issue.8, August- 2016, pg. 207-215, ISSN: 2320-088X.
17. **Festim Halili**, Avni Rustemi, "Bringing semantics to services: the OWL-s approach" , Bulgarian Journal for Engineering Design, BJED, issue 30, October 2016, pg. 17-25, ISSN:1313-7530.
18. **Festim Halili**, Avni Rustemi, "Modeling of an e-business system", International Journal of Computers and Technology, IJCT, Vol. 15 No.12, October 2016, pg.7308-7315, ISSN:2277-3061.

19. **F. Halili**, B. Rahmani and M.Kasa. “Defining Web Services and Data through Mathematical Expressions in Z-Language”. In International Journal of Science, Innovation and new Technology (IJSINT), vol.2, no.3, pp.51-56, February, 2012. ISSN: 2223-2257.
20. **F. Halili**, F.Idrizi, U. Lena and M.Kasa. “Towards the UML Design of Web Services”. In International Journal of Science, Innovation and new Technology (IJSINT), vol.1, no.3, pp.73-78, February, 2012. ISSN: 2223-2257.
21. **F. Halili**, A. Dika and M. Kon-Popovska. “Towards the Composition of Web Services and the Role of the Query Optimization”. In International Journal of Web Applications (IJWA), vol.4, no.2, pp.57-68, June, 2012. Print ISSN: 0974-7710, Online ISSN: 0974-7729.
22. **F. Halili**, I. Ninka, M. Kasa and S. Lushi, “The impact of UDDI pages and UML modeling of web services”, in International Journal of Science, Innovation and New Technology (IJSINT2014), issue no.7 2014, ISSN:2223-2257.
23. **F. Halili**, I. Ninka, A. Rustemi and M. Kasa Halili, “Gjetja e CPM dhe PERT për implementimin e një modeli për rangimin e shërbimeve”, Buletini i Shkencave të Natyrës, Botimi Nr. 14, pp.100-113, viti 2014, ISSN: 2305-882X.
24. **F. Halili**, M. Kasa Halili, M. Ameti and I. Ninka, “A new Framework for Service ranking including CPM/PERT methods ”, in Journal of Convergence Information Technology (JCIT), Vol.9, No3, pp.86-98, ISSN: 1975-9320, 2014, South Korea.
25. **Festim Halili**, Arben Zulfiu, “The growth of usability of home internet and 3G technology in the territory of the Municipality of Tetova, and the impact of electromagnetic waves on the human body, in International Journal of Universi, Vol. 01, Issue 03, ISSN: 1857-9450, pp.375-379, August 2015.

B. Konferenca Shkencore:

1. **Festim Halili**, E. Alihajdaraj, et.al, “Artificial Intelligence in Work Process Automation”, in the 3rd International Mediterranean Congress of Natural Sciences, Health and Engineering MESEC III, June 2019, Montenegro.
2. **Festim Halili**, G. Haxhijaj, B. Jashari, “Information Technology innovations in the role of human resource management in Telecom”, in ICONST 2019.
3. **Festim Halili**, N. Berisha, et.al, “Shfrytezimi i EDMODO per mesimdhienien e te shkruarit dhe angazhimi i nxenesve”, in International Conference “New emerging trends in Western Balkans”-NEWTB19, Struga, Macedonia, ISBN-978-608-4573-33-3.
4. **Festim Halili**, A. Laci and B. Suma, “Artificial intelligence and some of its methods in robotics – An overview” 2nd International Conference Towards Sustainable Development (TSD’2018) November 3, Skopje Macedonia, 2018.
5. **Festim Halili**, E. Rufati, et.al, “RESTful semantic tailored web services for e-business – An overview”, in abstract book of 2nd International conference of Natural Sciences and Mathematics, June 2018, Tetovo, Macedonia.
6. **Festim Halili**, et.al, “Formal Axiomatic Systems: A transition from M-mode to I-mode”, Guest speaker, in proc. Book of 1st International Multidisciplinary Scientific Conference IMSC2018, pp.267-275, ISBN: 978-608-66191-0-7.
7. **Festim Halili** and L. Spahija, “Review of Artificial Intelligence Development, its impact and its challenges”, in Proc. Book of International Conference of Computer Science and Communication Engineering, 27-28 October, Durres Albania.

8. **Festim Halili**, V. Misimi, R. Iseini and M. Salihi, “Mobile Cloud Computing: A new Way of Cloud Computing”, in proc. Book of International Conference of Computer Science and Communication Engineering. 27-28 October, Durres Albania.
9. **Festim Halili** and S. Kamberi, “Composition of Web Services for student evaluation system”, in 1st Conference of Applied Sciences Engineering and Mathematics, ICASEM 2017, May 2017, Struga-Ohrid, Macedonia, ISBN 978-608-65137-5-7.
